




Planuar / Doretuar Priljevit / Predato Received / Delovity	05-05-2021	1	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jedinita Org / Unit	Rr / Prot Rr / Prot Prot No	Shtojta Puteq Appendix	Sasia Kolicama Quantity
SKPMSTHJK	2202/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.263/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga Arben Mehmeti- kryetar, Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani- anëtarë,si dhe Rushit Kajtazi,Zyrtar Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.305/2019, të datës 03.06.2019 sipas Aktgjykimit A.nr.2416/2019,të datës 31.03.2021,të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ,të ankueses me adrese banimi Rruga "Presheva", nr. 311, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut,në çështjen juridike "kontestim konkursi",duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet ankesa A.nr. 305/2019 e datës 03.06.2019, e parashtruar nga ankuesja

II.Mbetet në fuqi Vendimi Nr-01-111/02-034175-2/19 i datës 22.05.2019 , i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut.

A r s y e t i m

Komuna e Mitrovicës së Jugut, me datën 07.02.2019,ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën „Zyrtar për Biblioteka 1“, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil.

Komuna e Mitrovicës së Jugut, me datë 11.02.2019, ka shpallur konkursin për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1“, në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 29.03.2019, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidates, për pozitën " Zyrtar për Biblioteka 1", me datë 24.04.2019,me

numër protokoll 01-11/020034175/19, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunë të Mitrovicës së Jugut.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me datë 22.05.2019, me numër protokoll 01-111/02-0034175-2/1, ka nxjerr vendim me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar në ligj.

Ankuesja, e pakënaqur me vendimin me nr. protokoll 01-111/02-0034175-2/1, të datës 22.05.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Mitrovicës së Jugut, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr.06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.05.2019, përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesë, e cila ankesë është pranuar me datën 03.06.2019, me numër protokoll 2546/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1", në Komunën e Mitrovicës së Jugut, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 06.06.2019, me numër protokoll 2598/2019, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa me datën 19.06.2019, me numër protokoll 2787/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, ku më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të këshillit ndërsa më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 30.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 30.08.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 31.03.2021, me numër A.nr.2416/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 30.08.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kthyer lëndën për vendosje në KPMSHCK.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 305/2019, e datës 03.06.2019, me numër protokoll 2546/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr. 2416/2019, të datës 31.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Autorizimi i datës 07.02.2019, i Ministrisë së Administratës Publike, Konkursi i datës 11.02.2019, Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë, Vendimi i datës 11.03.2019, për Themelimin e

Komisionit Përzgjedhës, Raporti për përcaktimin e kritereve për përfshirje në listën e ngushtë, Përcaktimi i Kritereve për Testim me shkrim dhe me gojë, për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj, Testi me shkrim, Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale, Renditja Përfundimtare e Kandidatëve, Raporti i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues, Njoftimi i datës 29.03.2019, për përzgjedhjen e kandidatit, Ankesë e datës 24.04.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Vendimi i datës 22.05.2019, me numër protokoli 01-11/02-0034175-2/1, Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura, Diplomë e datës 16.10.2015, Kontrata për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 11.09.2017, Kontrata për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 13.06.2016, Vërtetimi i datës 04.11.2015, Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura, Diplomë e datës 13.07.2015, Vërtetimi i datës 11.10.2018, Vërtetim i datës 15.02.2019, Njoftimi i datës 30.08.2019 Përgjigjeje në ankesë e datës 19.06.2019, me numër protokoli 2787/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në lidhje me këtë lëndë pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe të potencuara më lartë me rastin e administrimit të provave, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave fillimisht ka analizuar Aktgjykimin, me numër A.nr. 2416/2019, të datë 31.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 30.08.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke e detyruar të njëjtin të vendos lidhur me ankesën e datës 03.06.2019 të ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 11.02.2019, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, kriteret e konkursit kanë qenë:

- **Diplome Universitare; në fushën e Filologjisë, Gazetarisë, Komunikimit, Ekonomik**
- **Pa përvoje pune, shkolle e lartë dhe së paku (dy) vite përvojë pune**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore te ankueses se konkursi i datës 11.02.2019, i publikuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, se në vend të kushteve të konkursit të aftësisë/ përvoja dhe atributet tjera që kërkohet përmban **shkolle e lartë dhe së paku (dy) vite përvojë pune**, Kolegji konstaton se në konkursin e datës 11.02.2019, të publikuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, konkursi i përmban të gjitha kushtet dhe se në konkursin e shpallur, përveq që llogaritet lëshim më tepër i natyrës teknike nga organi i punësimit çështja sa i përket vendosje së pjesës” **shkolle e lartë dhe së paku (dy) vite përvojë pune** tek pjesa e aftësive/ përvojës dhe attributeve tjera që kërkohen e jo në pjesën e shkollimit të kërkuar për këtë pozitë, ndërsa edhe nëse shikojmë autorizimin e MAP-it të datës 11/02/2019, pjesa e kontestuar e tekstit: **shkolle e lartë dhe së paku (dy) vite përvojë pune është e vendosur tek pjesa shkathtësitë e kërkuara që afërsisht është i të njëjtit kuptim prandaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore sa i përket kësaj**

çështje janë të pabazuara nga se kjo lëvizje e këtij teksti brenda konkursit nga pjesa e shkollimit të kërkuar tek pjesa e aftësive / përvojës dhe attributeve tjera nuk ka ndonjë ndikim vendimtar nga se nuk ndikon në çështjen kryesore, sepse kandidatja e pranuar i ka plotësuar të gjitha kushtet sipas konkursit publik dhe se procedurat kanë qenë në rregull, përveç këtij lëshimi administrativë të natyrës teknike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmime për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkëngjitura në dosjen e kandidatës së përzgjedhur dhe të ankueses, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil i Komunës së Mitrovicës së Jugut, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën „Zyrtar për Biblioteka 1” , duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: „ Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes”, sepse kandidatja e përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 11.02.2019, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, sepse nga shkresat e lendes del se kandidatja ka të përfunduar Kolegjin UBT, drejtimi, Baçelor i Arteve në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e cila ka diplomuar me datë 24.06.2015.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmime për përvojën e punës të bashkëngjitura në dosjen e kandidatës së pranuar dhe në dosjen e ankueses ka konstatuar se përgatitja shkollore e kandidatës, së përzgjedhur ka qenë në pajtim me kriteret e përcaktuara me konkurs.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstatoi se vlerësimi i Komisionit Përzgjedhës i Shërbimit Civil të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për përzgjedhjen e kandidatës për pozitën “Zyrtar për Biblioteka 1” është në harmoni me legjislacionin që ka rregulluar këto procedura, ka vepruar në pajtim dhe me nenin 40 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet; **1. “Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve me shkrim dhe me gojë” 2. pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe me gojë mbledhen dhe pjesëtohen për dy”.**

Ndërlidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit, të zhvilluar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, është bërë në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale,



paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave mbi bazë të analizimit të hollësishëm të rastit, duke u bazuar në provat konkrete të ofruar nga palët, ka konstatuar se e terë procedura e rekrutimit, për pozitën „ Zyrtar për Biblioteka 1”, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, është zhvilluar në pajtim me të Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.01-11/02-0034175-2/1, të datës 22.05.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Biblioteka 1” , të zhvilluara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr. 263/2021, datë 05/05/2021

Rushit Kajtazi

Zyrtar Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben Mehmeti

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së